

Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Janar, 2016

Tiranë, më 10 Shkurt 2016: Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Janar 2016, arriti 100,9 % kundrejt muajit Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100).

Në muajin Janar 2016 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1,5 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,3 %.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore në muajin Janar është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,55 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Hotele, kafene e restorante” dhe “Argëtim e kulturë” kanë kontribuar me nga 0,03 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me -0,27 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,15 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,06 dhe çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me -0,03 pikë përqindje. (shih Fig 2. fq 2).

Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Janar 2015, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shërbimi arsimor” me 4,8 % pasuar nga grupi, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4,3 %, grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,3 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 24,7 %, pasuar nga nëngrupi “zarzavate përfshirë patatet” me 19,3 %, nëngrupi “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 1,4 %, nëngrupi “vajra dhe yndyrna” me 0,8 % etj. Çmimet e nëngrupit “qumësht, djath e vezë” u ulën me 5,5 %, pasuar nga nëngrupet “kafe, çaj e kakao” me nga 1,3 %, “mish” me 0,8 % etj. Ndërsa, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me 3,7 %, pasuar nga grupet “Transport” me 2,5 %, “Shëndeti” me 1,6 %, etj.

Ndryshimi mujor i indeksit është 0,9 %. Krahasuar me muajin Dhjetor 2015, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije alkoolike” me 2,5 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 3,3 %. Krahasuar me muajin e mëparshëm çmimet e eurodizelit u ulën me 5,8 % dhe çmimet e benzinës me 5,6 %.

Për publikim 10/02/2016

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit





Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Shënim: Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit shpreh kontributin që jep secili grup shpenzimesh në ndryshimin vjetor të shprehur në pikë përqindje. Shuma e kontributeve me vlera pozitive dhe negative jo domosdoshmërisht jep ndryshimin vjetor për shkak të rumbullakimeve gjatë procesit të llogaritjeve. Psh. edhe pse indeksi i grupit "Pije alkoolike dhe duhan" në muajin Janar 2016 u rrit me 3,3 %, kontributi në ndryshimin vjetor është + 0,16 pikë përqindje.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100 %

Kodi	Grupet	Peshat	01-15	02-15	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15	01-16
Gjithsej		100,0	99,4	101,8	102,2	101,7	100,1	99,0	98,4	99,1	99,7	99,7	99,4	100,0	100,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	36,1	98,3	103,7	104,7	103,8	100,1	97,8	96,3	98,2	99,4	99,3	98,7	100,0	102,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,0	97,3	98,3	98,6	99,1	99,3	99,6	99,3	99,5	99,5	99,6	99,4	100,0	100,5
3	Veshje dhe këpucë	4,0	103,2	101,5	100,8	100,6	100,4	99,8	99,3	98,5	98,5	99,3	99,8	100,0	99,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,3	102,1	102,1	101,6	100,1	100,0	100,2	100,3	100,3	100,3	100,0	100,0	100,0	100,7
5	Mobilije, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	99,4	99,2	99,3	99,4	99,6	99,4	99,5	99,6	99,5	99,4	99,5	100,0	100,3
6	Shëndeti	3,9	101,6	102,4	102,4	102,8	102,8	99,6	100,1	100,1	100,3	100,5	100,0	100,0	100,0
7	Transporti	6,3	99,2	99,9	100,8	101,6	101,9	102,3	102,7	102,0	101,2	101,2	100,0	100,0	96,7
8	Komunikimi	2,8	101,1	101,0	101,0	101,0	101,1	101,1	101,1	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
9	Argëtim dhe kulturë	2,8	99,0	99,5	99,4	99,3	99,4	99,3	98,9	99,1	100,0	100,2	100,1	100,0	100,2
10	Shërbimi arsimor	3,9	95,4	95,4	95,4	95,4	95,4	95,4	95,4	95,8	96,2	100,0	100,0	100,0	100,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,6	99,0	99,0	99,0	99,0	99,0	99,1	99,1	99,2	100,0	100,0	99,9	100,0	100,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,9	100,2	100,0	99,9	100,3	100,4	100,3	99,9	99,7	100,6	100,2	100,4	100,0	100,0

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	01-15/01-14	02-15/02-14	03-15/03-14	04-15/04-14	05-15/05-14	06-15/06-14	07-15/07-14	08-15/08-14	09-15/09-14	10-15/10-14	11-15/11-14	12-15/12-14	01-16/01-15
Gjithsej		1,3	2,3	2,2	2,3	1,8	1,4	1,3	1,9	2,2	2,1	2,1	2,0	1,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,2	4,8	4,7	5,2	3,8	2,7	2,4	4,2	4,9	5,5	5,9	5,1	4,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,6	6,3	6,3	6,5	6,8	7,0	6,6	6,7	6,9	6,1	3,3	3,3	3,3
3	Veshje dhe këpucë	0,1	-0,2	-0,9	-1,3	-1,2	-1,3	-1,0	-1,6	-2,1	-3,7	-4,0	-3,2	-3,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,7	0,7	0,3	-1,0	-0,8	-0,4	-0,3	-0,3	-0,2	-1,4	-1,7	-2,0	-1,3
5	Mobilije, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,2	-0,5	-0,1	-0,3	-0,1	-0,1	-0,1	-0,1	-0,4	-0,3	0,0	0,6	0,9
6	Shëndeti	-5,2	-4,5	-4,4	-1,5	0,1	-1,9	-0,8	-0,9	-0,6	-0,5	-1,3	-0,9	-1,6
7	Transporti	-3,7	-3,3	-2,2	-1,5	-1,4	-1,1	-0,9	-1,9	-2,5	-2,1	-2,8	-0,6	-2,5
8	Komunikimi	3,8	3,7	3,7	2,3	2,2	2,2	1,7	0,6	0,0	0,0	-0,8	-1,1	-1,1
9	Argëtim dhe kulturë	0,5	0,7	0,6	0,5	0,5	0,4	0,1	0,2	0,4	1,0	1,0	1,1	1,2
10	Shërbimi arsimor	11,0	10,2	10,3	10,1	10,1	10,1	10,1	10,4	10,5	4,8	4,8	4,8	4,8
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,6	1,4	0,6	0,6	0,5	0,4	0,3	0,5	0,8	0,6	0,7	1,1	1,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	2,9	-1,3	-1,7	-1,1	-1,0	-0,8	-0,7	-0,7	-0,1	-0,6	-0,1	-0,2	-0,1

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet	01-15	02-15	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15	01-16
	Gjithsej	1,4	2,4	0,4	-0,5	-1,6	-1,1	-0,7	0,8	0,6	0,01	-0,3	0,6	0,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,3	5,4	1,0	-0,8	-3,6	-2,3	-1,5	2,0	1,2	-0,1	-0,6	1,3	2,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,5	1,0	0,4	0,5	0,2	0,3	-0,3	0,2	0,0	0,1	-0,2	0,6	0,5
3	Veshje dhe këpucë	-0,1	-1,7	-0,7	-0,1	-0,3	-0,5	-0,5	-0,9	0,1	0,8	0,5	0,2	-0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,0	-0,5	-1,5	-0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	-0,3	0,0	0,0	0,7
5	Mobillje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	-0,2	0,1	0,1	0,1	-0,1	0,1	0,1	-0,2	-0,1	0,1	0,5	0,3
6	Shëndeti	0,7	0,7	0,0	0,4	0,0	-3,1	0,4	0,0	0,3	0,2	-0,5	0,0	0,0
7	Transporti	-1,5	0,7	1,0	0,8	0,3	0,4	0,4	-0,7	-0,8	0,0	-1,2	0,0	-3,3
8	Komunikimi	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-1,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	0,4	-0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,4	0,2	0,9	0,2	-0,1	-0,1	0,2
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,4	0,5	3,9	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2	0,8	0,0	-0,1	0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	-0,2	-0,1	0,5	0,1	-0,1	-0,4	-0,2	0,9	-0,4	0,2	-0,4	0,0

Informacion për përdoruesit

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT ME SHPORTËN E RE TË MALLRAVE

Instituti i Statistikave njofton të gjithë përdoruesit se Indeksi i Çmimeve të Konsumit nga muaji Janar 2016 do të llogaritet dhe publikohet me shportën e re të mallrave dhe shërbimeve.

Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë llogaritur bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve 2014.

Indeksi i ri llogaritet duke konsideruar si periudhë bazë muajin Dhjetor 2015, (Dhjetor 2015=100).

Indeksi i Çmimeve të Konsumit do të vazhdojë të publikohet në nivel vendi më datë 8 të muajit pasardhës në faqen e Web-it të INSTAT në adresën www.instat.gov.al.

Në faqen e Web-it të INSTAT, www.instat.gov.al, gjithashtu do të gjeni serinë kohore të indekseve në nivele më të detajuar. Të gjitha indekset e mëparshme janë rillogaritur me bazën e re (Dhjetor 2015=100) dhe do të publikohen në faqen e web-it paralelisht me publikimin e indeksit të muajit Janar 2016.

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), duke filluar nga muaji Janar 2016 llogaritet me shportën e re të artikujve, peshat e të cilave janë llogaritur bazuar në shpenzimet e Anketës së Buxhetit të Familjes, realizuar nga INSTAT gjatë vitit 2014. Muaji Dhjetor 2015 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2015 = 100). Ndryshimi i mëparshëm i shportës së artikujve është bërë në muajin Janar të vitit 2007, ku numri total i artikujve u rrit nga 262 në vitin 2002 në 271 artikuj. Në shportën e re numri total i artikujve është 333. Indeksi llogaritet dhe publikohet duke përdorur strukturën e Klasifikimit të Shpenzimeve sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 grupe kryesore, tërësisht të përputhshëm me klasifikimin e shpenzimeve që përdor EUROSTAT.

Ashtu si indeksi i mëparshëm edhe indeksi i ri do të mbulojë gjithë territorin e vendit (koncepti i peshave). Çdo produkt përfaqësohet në indeks me tre lloje peshash : pesha e produktit në nivel vendi, pesha e produktit në nivel qarku dhe pesha gjeografike. Indeksi do të vazhdojë të publikohet në nivel vendi. Çmimet do të mbliidhen në zonën urbane në 11 qarqe, përjashtuar qarkun e Kukësit i cili në indeks përfaqësohet nga qarku i Dibrës.

Për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Shqipëri përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0,i}^t = \frac{\sum_i P_i^t * Q_i^0}{\sum_i P_i^0 * Q_i^0}$$

Peshat ($w = P*Q$) e periudhës bazë janë përdorur për llogaritjen e indeksit:

$$I_{0,i}^t = \sum_i w_i * \left(\frac{P_i^t}{P_i^0} \right)$$

Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo qark duke përdorur mesataren gjeometrike :

$$PR_{t-1,ij}^t = \prod_{k=1}^n \left(\frac{P_{ijk}^t}{P_{ijk}^{Dec(t-1)}} \right)^{1/n}$$

Lidhja zinxhir me indeksin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm jep çmimin relative krahasuar me periudhën bazë.

$$PR_{0,ij}^t = PR_{0,ij}^1 * \dots * PR_{Dec(t-1),ij}^t$$

IÇK rajonale llogaritet si më poshtë.

$$RIÇKI_{i,0}^t = \sum_i r_{ij} * PR_{0,ij}^t$$

Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë.

$$I_{0,i}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_j r_{ij} = 1 \quad : \quad \forall_i \text{ (për të gjitha rastet)}$$

Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK e Shqipërisë:

$$IÇK_0^t = \sum_i w_i * I_{0,i}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_i w_i = 1$$

Legjenda:

P	çmimi
PR	çmimi relativ
I	indeksi
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
t	periudha korente t
t=0	periudha bazë 0
r	peshat gjeografike
w	peshat e produkteve
j	numri i prefekturave
i	numri i produkteve

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.